



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1211 Prot.

Tiranë, më 03.102018

VENDIM Nr. 173, datë 25.09.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.09.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "HEC -et Lajthia, Kolesjan, Domje" Përroi i Thatë, Bashkia Kukës- subjekti "LAJTHIA & KOLESJAN ENERGY" sh.pk., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "HEC -et Lajthia, Kolesjan, Domje" Përroi i Thatë, Bashkia Kukës- subjekti "LAJTHIA & KOLESJAN ENERGY" sh.pk., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "LAJTHIA & KOLESJAN ENERGY" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC -et Lajthia, Kolesjan, Domje" Përroi i Thatë, Bashkia Kukës, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al